



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
PERMET.

RAPORTI VJETOR

Në Përmet me 21.02.2020

Në përputhje dhe zbatim te Kushtetutës së Shqipërisë, Kodit të Procedures Penale, ligjin nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” paraqesim raportin vjetor per punen e kryer, arritjet dhe problematikat e hasura nga Prokuroria Prane Gjykates Shkalles Pare Permet per vitin 2019.

1 Prokuroria pranë Gjykatës Shkallës Parë Përmet, për vitin 2019 ka respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut të sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Konventen Europiane të të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, Kodin e Procedurës Penale dhe aktet e tjera ligjore, për gjithë personat e përfshirë në hetime, pavarësisht rolit që kanë pasur të dëmtuar nga vepra penale, të pandehur, interesuar ose dëshmitar.

1.1 Për vitin 2019 në Prokurorinë Përmet është regjistruar 1(një) procedim penal me të pandehur të mitur për veprën penale të “Shkatërrimit te prones nga pakujdesia” parashikuar nga neni 161 K.Penal, i cili hetohet në gjendje të lirë. Në 2(dy) procedime penale, të miturit janë viktima të veprës penale dhe konkretisht në një procedim për veprën penale “ Përndjekja” parashikuar nga neni 121a/2 i K.Penal dhe në 1 (një) procedim penal regjistruar fillimisht për veprën penale “Ngacmim seksual” parashikuar nga neni 108/a K.Penal, por nga hetimet ka rezultuar se ky fakt penal nuk provohet.

Në përputhje me ligjin Nr. 37/2017 “Kodi i drejtësisë penale për të mitur” në Prokurori është krijuar një seksion për të miturit, por për shkaqe objektive nuk është arritur të plotesohet vendi vakant i koordinatorit.

1.2 Bashkëpunimi ndërinstitucional ka qënë përgjithësisht i mirë dhe pa problematika të theksuara. Në vitin 2020 kërkohet dhe do të vihet theksi në një bashkëpunim më të madh dhe efikas me Shërbimet e Policisë së Shtetit si dhe me organet e qeverisjes vendore në luftën kundër krimít të “Kultivimit të bimëve narkotike” parashikuar nga neni 284 K.Penal. Vlen për t'u veçuar bashkëpunimi shumë i mirë me Zyrën e Përmbarimit Gjyqësor Përmet, Shërbimin e Provës Përmet.

1.3 Sa i përket përdorimit të metodave speciale të hetimit dhe hetimeve proaktive, ato janë kryer në 3(tre) raste.Në hetimin për veprën penale të “Vrasjes me dashje” parashikuar nga neni 76 K.penal, për 1 (një) procedim penal regjistruar për veprën penale “ Kultivimi i bimëve narkotike” parashikuar nga neni 284/2 K.Penal dhe në1(një) procedim penal regjistruar për veprat penale të parashikuara nga nenet 183/2, 190/2,278, 283/2 të K.Penal.

1.4 Nuk ka pasur asnjë procedim penal në lidhje me procesin e verifikimit të integritetit të personave që ushtrojnë detyra shtetërore ose funksione publike.

2. Për vitin 2019 janë rregjistruar në total 220 materiale kallëzuese, nga të cilat 160 janë rregjistruar si procedime penale, 83 procedime penale janë mbartuar nga viti 2018.

Në total janë hetuar 243 procedime penale dhe 60 kallëzime penale për të cilat është vendosur mosfillimi i procedimit penal , me 100 persona nën hetim ,nga të cilët 50 janë marrë në cilesinë e të pandehurit. Për 30 persona nën hetim janë mbartuar çështjet për vitin 2020.

Për 18 procedime penale, ka pasur zgjatje të afatit të hetimeve paraprake, me 46 persona nën hetim ,nga të cilët 9 persona me masë sigurimi “arrest në burg”, 1 me masë sigurimi “detyrim paraqitje në policinë gjyqësore “ dhe të tjerët në gjendje të lirë.

Për 14 procedime penale është marrë zgjatje afati deri në 3 muaj.

Për 1 procedim penal zgjatja ka qenë deri në 1 vit.

Për 3 procedime penale zgjatja ka qënë mbi afatin 6 mujor

2.1 Çështje të përfaqësuar në gjykatë.

Janë derguar 40 kerkesa për kalim çështje për gjykim, me 50 të pandehur.

Janë pranuar nga gjykata 24 kërkesa për kalim çështje për gjykim.Janë pushuar 8 kërkesa për kalim çështje në gjyq , nga të cilat 2 vendimarrje janë ankimuar dhe Gjykata e Apelit për keto 2 apelime ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës Shkallës Parë. Për 7 çështje për të cilat është kërkuar dërgimi për gjykim nga prokurori, janë rikthyer çështjet për hetime të mëtejshme duke mos pranuar kërkësen për kalim çështje për gjykim.

Për 5 procedime penale të dërguara për gjykim me urdhër penal , rezulton se këto urdhëra janë miratuar në total nga gjykata.

3 procedime penale me 3 të pandehur hetuar në gjendje të lire, janë dërguar për gjykim me marrëveshje, nga të cilat 2 marrëveshje janë miratuar nga gjykata dhe për 1 procedim penal është kthyer çështja për hetime të mëtejshme .

Për 9 procedime penale është shpallur moskompetenca dhe kalimi i akteve në prokuroritë përkatëse .

Për 30 procedime penale me 6 persona nën hetim, hetuar në gjendje të lirë është kërkuar pushimi i çështjes ,nga të cilat 16 kërkesa janë pranuar nga gjykata. Për 7 procedime penale është kthyer aktet prokurorit dhe për 7 procedimete tjera vazhdon gjykimi ende për vitin pasardhës. Jane pushuar 7 procedime penale me vendim prokurori, sepse kanë qënë kundërvajtje penale.

Për 22 procedime penale është vendosur pezullimi i procedimeve penale për mosbulim të autorëve .

Janë mbartur për vitin 2020 gjithsej 130 procedime penale.

2.3 Burimet e njoftimeve të veprave penale janë ato klasiket dhe të zakonshmet.

• Shërbimet e policisë pranë Komisariatit të Policisë Përmet dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokaster kanë referuar 154 raste, kryesisht janë: 3 referime për veprën penale të “Kultivimit te bimeve narkotike” parashikuar nga nenet 284, 23 rareferime për veprën penale të “Vjedhjes”, parashikuar nga neni 134 i K.Penal, 8 referime për faktin e “Vetëvrasjes” ose ndryshe për nenin 99 K.Penal, 4 referime për veprën penale të “Dhunës në familje”, parashikuar nga neni 130/a i K.Penal.

- Nga shërbimet e policisë pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastër janë kryer ; 8 referime për faktin e veprës penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikeve”, parashikuar nga neni 283 K.Penale, 7 referime për veprat penale të “Shkeljes se rregullave te qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290 K.Penal dhe “Drejtimit pa dëshmi të automjetit” , parashikuar nga neni 291 i K.Penal, 2 referime për veprën penale të “Plagosje rende me dashje”, parashikuar nga neni 88/1 K.Penal, 1 referim për veprën penale të “Vrasjes me dashje”, parashikuar nga neni 76 K.Penal.
- 30 referime kanë qënë nga shtetasit , kryesisht për veprat penale të “Falsifikimit të dokumentave” ,parashikuar nga neni 186 K.Penal, “Shpërdorimi detyrës”, parashikuar nga neni 248 K.Penal,“Vjedhjes” ,parashikuar nga neni 134 i K.Penal dhe për kundërvajtje penale që ndiqen me ankim ose me kërkëse të dëmtuarit akuzues.
- Nenpunësit publik dhe organet e tjera kanë referuar 31 raste.

Veprat penale me shume te regjistruar dhe hetuara për vitin 2019 janë;


Neni 76 K.Penal 1 procedim.

Neni 88/1 K.Penal 2 procedime.

Neni 130a K.Penal 5 procedime.

Neni 134 K.Penal 31 procedime.

Nenin150 K.Penal 10 procedime.



Neni 151 K.Penal 6 procedime.

Neni 186 K.Penal 57 procedime.

Neni 248 K.Penal 9 procedime.

Neni 283 K.Penal 11 procedime.

2.4 Nga 100 persona në hetim, për vitin 2019, 12 persona janë hetuar me masë sigurimi “Arrest në burg” - parashikuar nga neni 238 K.Pr.Penale, 3 me masë sigurimi “arrest në shtëpi”- parashikuar nga neni 237 K.Pr.Penal, 8 me masen e sigurimit personal “Detyrim paraqitje ne policine gjyqësore”- parashikuar nga neni 234 K.Pr.Penale, 4 persona jane hetuar me masë garanci pasurore dhe 1 (një) person hetuar me masë ndaluese.

- Janë arrestuar në flagrancë 29 persona dhe ndaluar 2 në përputhje me nenet 251,252 dhe 253 K.Pr.Penale me iniciativë të policisë - 31 persona.

4 të arrestuar për vepren penale të “ Plagosje e rëndë me dashje”, parashikuar nga neni 88 K.Penal.

1 i ndalur për veprën penale të “Vrasjes me dashje”, parashikuar nga neni 76 K.Penal

2 të arrestuar për veprën penale të “Dhunës në familje”, parashikuar nga neni 130/a K.Penal.

1 i ndaluar për veprën penale “Vjedhje” , parashikuar nga neni 134/1 K.Penal.

1 i arrestuar për veprën penale “Organizimi llotarive të palejuara” , neni 197/1 K.Penal.

1 i arrestuar për veprën penale të “ Kundështim të punonjësit të policisë së rendit publik” , parashikuar nga neni 236 K.Penal.

3 të arrestuar për vepren penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyese dhe municionit” , parashikuar nga neni 278/2 K.Penal.

3 të arrestuar për vepren penale “Prodhim dhe shitja e narkotikeve”, parashikuar nga neni 283/1 K.Penal.

5 të arrestuar për vepren penale “Prodhim dhe shitja e narkotikeve” ,parashikuar nga neni 283/2 K.penali.

5 të arrestuar për vepren penale të “Kultivimit të bimeve narkotike” ,parashikuar nga neni 284/2 K.Penal.

1 i arrestuar për vepren penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor” ,parashikuar nga neni 290/1i K.Penal.

3 të arrestuar për veprën penale “Drejtim i automjetit në gjendje të parregullt”,parashikuar nga neni 291 i K.Penal.

1 i arrestuar për veprën penale “Ndihma për kalim të paligjshem të kufirit” ,parashikuar nga neni 298/2 K.Penal.

- Nga ana e Prokurorit, janë nxjerrë 3 urdhëra për lirime të menjëherëshme për tre të arrestuar: 1 i arrestuar për veprën penale “Plagosje e rënde me dashje”, parashikuar nga neni 88 K.Penal, 1 i arrestuar për vepren penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit

rrugor” ,parashikuar nga neni 290/1 i K.Penal dhe 1 i arrestuar për veprën penale “Kundështim te punonjësit të të policisë së rendit publik” parashikuar nga neni 236 K.Penal.

- Jemi drejtuar gjykatës me kërkesa për vleftesim të ligjshem të arrestimit dhe caktim mase sigurimi për 28 persona,duke kërkuar për 21 persona të arrestuar masën e sigurimit “arrest në burg”, për të cilët gjykata ka vendosur këtë masë sigurimi për 12 shtetas, për 5 (pesë) kërkesa ka vendosur masën “Detyrim paraqitje në policinë gjyqësore” dhe për 4 të tjera ka vendosur masën “garanci pasurore”.

Për 1 arrestuar është kërkuar masa “arrest shtepie” nga prokurori ,kërkese e cila është pranuar nga gjykata.

Për 3 të arrestuar është kërkuar masa e sigurimit “detyrim paraqitje në policinë gjyqësore ” , pranuar nga gjykata të 3 (tre) kerkesat.


Janë kërkuar 2 masa ndaluese , gjykata ka pranuar vetëm 1(një) kërkesë për vendosjen e masës ndaluese dhe mos pranuar kërkesen tjeter.

Per 1 të arrestuar është kërkuar granci pasurore , e cila është pranuar nga gjykata .

2.5 Në zbatim të vendimeve penale të formes së prre është urdhëruar ekzekutimi i dënimive penale për 30 të dënuar. Urdhërat e ekzekutimit, janë nxjerrë në afatet dhe procedurat të përcaktuar nga nenet 463-468 te K.Pr.Penale **dhe** ligji nr. 8331 date 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”.

2.6 Sipas strukturës të Kodit Penal konstatohet një shtim i krimeve që parashikojnë dënim në maksimum me burg mbi shtate vjet dhe më konkretisht për veprat penale e “Prodhim dhe shitje e narkotikeve” ,parashikuar nga neni 283 K.Penal, “Kultivim te bimeve narkotike”, parashikuar nga neni 284/2 K.Penal.

3.Për vitin 2019 janë hetuar 160 procedime penale me 80 persona nën hetim, 40 procedime penale me 50 të pandehur janë dërguar për gjykim dhe janë dënuar në vitin 24 të pandehur, për 8 të pandehur është pushuar çështja në séance paraprake dhe për 18 pandehur vazhdon gjykimi për vitin 2020.



3.1 Për vitin 2019 janë dërguar për gjykim 40 procedime penale me 50 të pandehur, 6 janë gjykuar me masë sigurimi “arrest burg”, 2 pandehur me masë sigurimi “arrest në shtëpi” , 6 të pandehur me masën “detyrim paraqitje në policinë gjyqësore “ dhe pjesa tjeter hetuar në gjendje të lirë.

Kanë përfunduar gjykimin 24 çeshtje me 24 te pandehur.

Për 2 çeshtje është kërkuar në gjykatë miratimi i marrëveshjes për 2 të pandehur.

5 procedime penale janë dërguar për miratim urdheri penal me 5 pandehur.

4. Në vitin 2019 janë dërguar 40 procedime penale për gjykim me 50 të pandehur, nga të cilet 6 me masë sigurimi “Arrest në burg”, 2 arrest në shtëpi dhe 8 detyrim paraqitje në policinë gjyqësore.

- Me gjykim të drejpërdrejt janë zhvilluar 5 çeshtje me 6 të pandehur, 3 në gjendje të lirë, 2 detyrim paraqitje në policinë gjyqësore dhe një arrest në burg.
- Janë zhvilluar 17 çeshtje me gjykim të shkurtuar, me 23 të pandehur të deklaruar fajtor.
- Me gjykim të zakonshëm 19 gjykime nga të cilat kanë përfunduar 9 gjykime në shkallë të parë.

Vendimarrja e gjykatës shkallës parë është dhënë për 34 të pandehur duke vendosur.

Kanë marrë pafajesi 8 të pandehur.

Dënuar me gjobë 6 të pandehur

Dënuar me burg në minimum 1 i pandehur

Me burgim në masen mesatare që parashikon dispozita 9 të pandehur.

Dënuar me denime alternative ”pezullim i denimit me burg “ sipas nenit 59 K.Penal ose punë në interes publik ,parashikuar nga neni 63 K.Penal -13 të pandehur.

Janë mbartuar në gjykim për vitin 2019, 83 çeshtje me 15 të pandehur, nga të cilët 13 me masë sigurimi” arrest në burg” , 4 me” detyrim paraqitje në policinë gjyqësore” dhe 15 gjykohen në gjendje te lirë.

4.1 Në përgjithesi kerkusat për masat dhe llojet e dënimive të kërkua nga Prokurori i çeshtjes janë mbeshtetur dhe pranuar nga gjykata.

4.4 Të pandehurit e dërguar për gjyq rezulton se pjesa me e madhe e tyre janë të padënuar me parë, banor në zonat rurale dhe të papun¹⁷ ose te vete punësuar.

Në lidhje me arsimimin rezulton se 35 pandehur janë me arsim tetëklase, 10 me arsim të mesëm, 5 me arsim të lartë dhe vetem 1 e gjinisë femerore, asnjë i mitur.



Banor të rrëthit Përmet janë 46 të pandehur në qytetet Këlcyrë dhe Përmet dhe në zonat rurale, pjesa me e madhe janë të papune ose vetë punësuar në bujqesi dhe 4 katër të pandehur janë nga rrrethe te tjera .

5. Në fushën e mardhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja, vlen për tu thikesuar së në ndryshim nga vitet paraardhese është kërkuar dhe urdhëruar shpallja për kërkim ndërkombëtar për të pandehur, hetuar me masë sigurimi arrest në burg për vepra penale të rënda aktualisht të gjithë janë në gjyq dhe tre prej tyre janë dënuar me burg me vendim te formes së prerë.

6. Ngarkesa Sipas Prokuroreve.

6.1 Prokurore Silvana Pani gjatë vitit 2019 ka hetuar 106 procedime penale nga të cilat 73 regjistruar rishtazi në vitin 2019 dhe 33 të mbartuara nga viti 2018 duke vendosur këtë zgjidhje për këto procedime penale.

22 cështje është kërkuar kalim për gjykim në gjykatë. Për 14 cështje është vendosur pezullimi procedimit penal, për 16 cështje është vendosur pushimi procedimit penal. Për 7 cështje është vendosur moskompetenca, për 2 cështje është kërkuar miratim i marrëveshjes dhe 1 cështje miratimi i urdherit penal në gjykate dhe mbartur për vitin pasardhes 43 cështje penale.

Për 38 materiale kallezuese është vendosur mosfilimi.


Ka kryer në(një) procedim penal veprime proaktive për vegren penale “Vrasje me dashje”, parashikuar nga neni 76 K.Penal.

Në cilësinë e prokurores në seksionin e ekzekutimeve tëvendime penale, ka nxjerrë 30 urdhër ekzekutimi dhe ka mbikqyrur në kohë reale ekzekutimin e vendimeve penale dhe në respekt të neneve 463 të K.Pr.Penale dhe ligjit Nr. 8331 datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, ligjit për shërbimin e provës dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore.

Ka pasur për 6 procedime penale zgjatje të afatit të hetimeve paraprake dhe konkretisht për një procedim penal për vegren penale të “Vrasjes me dashje”, parashikuar neni 76 K.Penal, ka zgjatje në afatin 1 vjecar, me një të pandehur të arrestuar. Për një procedim penal për veprën penale “Plagosje e rëndë me dashje” , parashikuar nga neni 88 K.Penal, zgjatje në afatin 6 mujor me një person nën hetim, hetuar me masën e sigurimit personal “Garanci pasurore” , parashikuar nga neni 236 K.Pr.Penale.

Për 1 procedim penal për vegren penale “Shperdorimi detyres” parashikuar nga neni 248 K.Penal, me një të pandehur hetuar në gjendje të lirë .

Për një procedim penal për veprën penale “Kultivim i bimëve narkotike” , parashikuar nga neni 284/2 K.Penal, me 4 pandehur me masë sigurimi “arrest në burg” , ka marre një zgjatje në afatin 3 mujor.



Për një procedim penal për veprën penale “ Ndërtim i paligjshëm ” , parashikuar nga neni 199°a i K.Penal ka marrë një zgjatje me afat 3 mujor, me 1 person nën hetim, në gjendje të lirë.

Për një procedim penal për vepren penale “ Vrasje nga pakujdesia ” , parashikuar nga neni 85 K.Penal, ka marre zgjatje në afatin 6 mujor, me 1 person nën hetim.

6.2 Prokurori Hysen Keta ka pasur këtë ngarkesë:

Ka marrë rishtazi 36 cështje penale per vitin 2019 dhe ka mbartuar 53 cështje nga viti 2018 me një total cështjesh të hetuar per vitin 2019 - 89 cështje penale . Duke dhënë këtë zgjidhje 16 cështje janë dërguar për gjykim, 7 pezulluar, 2 shpallur moskompetencia, 4 dërguar për gjykim me per miratim urdhëri penal, 12 cështje është kërkuar pushim cështjes në gjykatë, 2 cështje janë pushuar me vendim prokurori dhe ka mbajtur në dorë 46 cështje penale.

Me largimin nga detyra në datë 25.07.2019 të Prokurorit Hysen Keta gjithe ngarkesa ka kaluar tek prokurori pasardhës.

Per 18 materiale kallëzuese është vendosur mosfillimi procedimit penal.

6.3 Prokurori Asllan Barjamaj.

Ka hetuar 56 cështje penale për vitin 2019, duke dhënë kete zgjidhje: 2 cështje janë dërguar për gjykim, 2 janë pezulluar, 3 janë pushuar dhe janë mbartuar 41 cështje dhe duke shtuar dhe cështjet e marra nga prokurori pasaradhes Hysen Keta prej 46 cështje penale, ka mbartuar në total për vitin pasaradhes 87 cështje penale.

Për 3 materiale kallëzuese është vendosur mosfillimi procedimit penal.

Ka kryer në 2 procedime penale veprime proaktive - regjistruar për veprat penale “ Prodhim dhe shitje e narkotikeve ” , parashikuar nga neni 283 K.Penal dhe “ Kultivimi i bimeve narkotike ” , parashikuar nga neni 284 K.Penal.

- Për 11 procedime penale ka zgjatje të afatit të hetimeve paraprake, për një afat 3 mujor dhe konkretisht.

Per 2 procedime penale - regjistruar për vepren penale “ Prerje paligjshme e pyjeve ” , parashikuar nga neni 205 K.Penal, me persona nën hetim në gjendje të lirë.

Për 2 procedime penale - regjistruar për vepren penale “ Fshehje e të ardhurave ” , parashikuar nga neni 180 K.Penal, me 2 persona nën hetim në gjendje të lire .

Për 4 procedime penale - hetuar për vepren penale “ Prodhim dhe shitja narkotikeve ” , parashikuar nga neni 283/2 K.Penal, me 4 persona nën hetim, hetuar me masen e sigurimit personal “ arrest në burg ” .

Për 1 procedim penal - për veprën penale “ Organizimi i llotarive të palejuara ” , parashikuar nga neni 197 K.Penal, me 5 persona nën hetim, 4 në gjendje të lirë dhe një me masë sigurimi “ detyrim paraqitje në policinë gjyqësore ” .

Per 1 procedim penal - për vepren penale “ Mashtrim ” , parashikuar nga neni 143 K.Penal, me 2 persona nën hetim, në gjendje të lirë.

Për 1 procedim penal - për vepren penale “Përndjekja” , parashikuar nga neni 121a/2 K.Penal me një person nën hetim, hetuar në gjendje të lirë.

Ka kërkuar në një rast kthim aktesh nga Gjykata, kur cështja ka qënë në gjykim në themel dhe kërkesa është pranuar nga gjykata dhe aktualisht cështja është në hetim, për vepren penale “Prodhim dhe shitja narkotikeve” ,parashikuar nga neni 283/1 K.penal.

Sekcionet e Policise Gjyqësore.

Sa i përket policise gjyqesore te sektionit pranë Prokurorisë Shkallës Parë Përmet, rezulton se është kryer një punë e konsiderueshme për vitin 2019, nga oficeri Agron Nakollari. Ka pasur në hetim 112 procedime penale të deleguara nga prokurorët dhe 6 kallëzime penale.

Për 30 procedime ka referuar dërgimin për gjykim.

23 procedime ka relatuar për pushim cështje.

9 për pezullim të procedimit penal.

3 procedime ka relatuar për tu transferuar dhe ka në hetim 47 procedime penale.

Kryen detyrat e deleguara dhe urdhëruara nga prokurori, por gjithsesi konstatohet vonesë në kryerjen e veprimeve të deleguara, duke mos i kryer në afatin e përcaktuar në urdhër dhe në një kohë të shpejte.

Shërbimet e policisë gjyqësore në Komisariatin Përmet dhe Drejtoretë Vendore të Policisë, kanë kryer 162 referime për vitin 2019 dhe kanë hetuar 132 procedime penale. Bazuar në urdhërat me shkrim të delegimit të kryera nga prokurori, kanë përfunduar dhe kryer veprimet e deleguara në afatin e përcaktuar përgjithësisht. Shqetësim mbetet mënyra e hetimit të veprave penale të “Kultivimit të bimeve narkotike” , parashikuar nga neni 284 K.Penal, “Prodhim dhe shitja e narkotikeve” , parashikuar nga neni 283 K.Penal, “Ndihme për kalim të paligjshëm të kufirit” parashikuar nga neni 298 K.Penal dhe veprat penale në fushën e doganave , pasi rrathi Përmet ka pikë doganore dhe kufitare , por referimi për veprat penale në fushën e doganave pothuajse mungon nga shërbimet e policisë gjyqësore.

Në një rast, te kultivimit të bimeve narkotike ,është njoftuar paraprakisht prokurori, me qëllim për tu bërë pjesë aktive e hetimit, për identifikimin e autoreve, për të kryer veprime hetimore speciale dhe posacme që do të ndihmojnë hetimin dhe identifikimin e autoreve dhe ky rast ka rezultuar me sukses.

Kërkohet një hetim me i thellë dhe i detajuar pikërisht për faktin penal të “Kultivimit të bimeve narkotike” , parashikuar nga neni 284 K.Penal dhe “Prodhim dhe shitje e narkotikeve”, parashikuar nga neni 283 K.Penal.

7. Buxheti për vitin 2019 është zbatuar në mënyrë korrekte dhe pas një auditimi të kryer në vitin 2019, janë marrë masat për të rregulluar problematikat në dokumentacion që janë vrejtur nga auditimi. Konstatohet një buxhet mjaft i kufizuar dhe jo i mjaftueshem për të kryer investimet në mbajtjen e paisjeve të punes, bazës materiale dhe për vitin 2020 kjo problematikë ekziston.

Mardheniet me publikun kanë qënë jo problematike dhe brenda korrnizave që përcakton ligji. Ka shqetësim sa i përket bazës materiale dhe konkretisht mungon një automjet që të funksionojë në mënyre efikase për të kryer levizjen e punonjeseve për arsyen pune. Është kërkuar një automjet ne gjendje tenknie optimale, pasi ekzistuesi eshte prodhim i viti 2004.

Respektimi i disiplinës në punë dhe etika ka qënë korrekt nga punonjësit.

8. Për vitin 2020 përparësi kryesore është lufta kundër fenomenit të “Kultivimit të bimëve narkotike” në zonat rurale te rethit Përmet, shtimi i numrit të personave në hetim dhe të marrë në përgjegjsi penale për këtë vepër penale.

DREJTUESI PROKURORISË
Asllan BARJAMAJ.

